



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

REKTORI

Nr. 1624 Prot

Shkodër, më 14.05.2024

URDHËR

Nr. 32, datë 14.05.2024

Bazuar në nenin 36 pika 7 dhe nenin 39 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Universitetin e Shkodrës", (e ndryshuar) neni 5 pika 3, neni 6 pika 1 gërma a) dhe neni 37 pika 1 si dhe në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 101, datë 13. 03. 2024 "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë", në cilësinë e titullarit të institucionit :

URDHËROJ

1. Shtyrjen e afatit të aplikimit për në KIZ (Komisionin Institucional të Zgjedhjeve), për Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të USH-së.
2. Shtyrjen e afatit të aplikimit për në KA (Komisionin e Apelimit) , për Fakultetin e Drejtësisë të USH-së.
3. Dita e dorëzimit të aplikimeve për të dy fakultetet është data 16. 05. 2024 nga ora 08:00 deri në 12:00.
4. Aplikimet dorëzohen pranë sekretares së Senatit Akademik të USH-së.
2. Ky urdhër i përcillet për njohje dhe zbatim Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Fakultetit të Drejtësisë dhe Sekretares së Senatit të USH-së.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI
Prof. dr. **Rajmonda Këçira**

